



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:007089

Datë: 03.05.2024

Numri i dokumentit: 05652418

PKR.nr.257/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Krime të Rënda, Kryetari i Trupit Gjykues Alban Ajvazi, si dhe me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Leutrim Hoti, në çështjen penale të pandehurve: R.A, A.M, R.Z, F.M dhe R.RR, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Falsifikimi i rezultateve të votimit nga neni 219 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti për Krime të Rënda, PP.I.34/21 të datës 27.04.2021, konform dispozitave të nenit 287 par.1 të KPPRK-së dhe nenit 357 par.1, nënpar.1.3 të KPPRK-së, me datë 03.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti për Krime të Rënda, PP.I.34/21 e datës 27.04.2021.

PUSHOHET procedura penale kundër të pandehurve:

I. R.A, nga i ati A. dhe nëna Xh., e gjinisë V., i lindur më ..., në ..., në Podujevë, ku edhe jeton në ..., i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer fakultetin ekonomik, me profesion ekonomist, me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

II. A.M, nga i ati F. dhe nëna H., e gjinisë P., i lindur më ..., në fshatin ..., ku edhe jeton në ..., i gjendjes së mesme ekonomike, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, student, me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

III. R.Z, nga i ati S. dhe nëna V., e gjinisë S., i lindur më ..., në ..., Komuna Podujevë, ku edhe jeton në ..., i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar, me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

IV. F.M, nga i H. dhe nëna Z., e gjinisë P., i lindur më ..., në ..., në Podujevë, ku edhe jeton në ..., i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar, ka të kryer shkollën fillore, me profesion mjeshtër, me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

V. R.RR, nga i ati Sh. dhe nëna S., e gjinisë A., i lindur më ..., në Podujevë, me adresë banimi në ..., Komuna Podujevë, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar, me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

- Për shkak se prokurori i shtetit është tërhequr nga aktakuza para fillimit të shqyrtimit gjyqësor.

Shpenzimet e procedurës penale mbesin në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzë nën shenjën PP.I.34/21 të datës 27.04.2021, kundër të pandehurve: R.A, A.M, R.Z, F.M dhe R.RR.

Gjykata me datën 11.01.2023 ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën të pandehurit ishin deklaruar të pa fajshëm për veprën penale e cila i vihet në barrë, me ç'rast gjykata i ka udhëzuar të njëjtit që brenda afatit prej 30 ditësh të paraqesin: çdo kundërshtim ndaj provave të cekura në aktakuzë dhe çdo kërkesë për hedhje të aktakuzës.

Të pandehurit A.M, R.Z, F.M dhe R.RR, nuk kanë paraqitur kërkesë për kundërshtim të provave dhe kërkesë për hedhje të aktakuzës. Ndërsa mbrojtësi i të pandehurit R.A, av. Ali Ajeti, brenda afatit ligjor gjykatës i ka paraqitur kërkesë për kundërshtim të provave dhe kërkesë për hedhje të aktakuzës. Pas kësaj Gjykata me Aktvendimin e saj nën shenjën PKR.nr.257/21 të datës 21.03.2023 e ka refuzuar kërkesën e lartcekur, ku pala kundër këtij aktvendimi brenda afatit ligjor ka ushtruar ankesë.

Gjykata Apelit me aktvendimin e saj nën shenjën PN.nr.426/23 të datës 05.05.2023 e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e mbrojtësit të pandehurit R.A, av. Ali Ajeti.

Prokurori i shtetit Bashkim Zeqaj para fillimit të shqyrtimit gjyqësor, me parashtresën e datës 30.04.2024, e ka njoftuar gjykatën se tërhiqet nga ndjekja penale, ndaj të pandehurve R.A, A.M, R.Z, F.M dhe R.RR në drejtim të veprës penale në bashkëkryerje Falsifikimi i rezultateve të votimit nga neni 219 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për shkak se është krijuar praktika gjyqësore që në raste të njëjta penale aktakuza është refuzuar ose është marr aktgjykim lirues nga gjykata si dhe duke pas parasysh dashjen të pandehurve si element parësor i kryerjes së veprës penale.

Gjykata pas analizimit të shkresave të lëndës dhe analizimit të bazës ligjore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, pasi që janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore të parapara me këtë dispozitivë ligjore.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës, u mor në bazë të nenit 453 par.1 të KPRK-së.

Nga sa u tha më larte në bazë të nenit 287 par.1 të KPPRK-së dhe nenit 357 par.1, nënpar.1.3 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv te këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr.257/21, datë 03.05.2024

Numri i lëndës: 2021:007089
Datë: 03.05.2024
Numri i dokumentit: 05652418

Kryetari i Trupit Gjykes - Gjyqtari
Alban Ajvazi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesa dhe mund të ushtrohet nga palët e pa kënaqura brenda pesë (5) ditëve, nga dita e pranimit, përmes kësaj gjykate, duke ju drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë.